

KËRKESË
Nr. 1692, datë 5.6.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“ROLAND KËNDEZI”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- **“ROLAND KËNDEZI”**

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000493-5

Datë 17.5.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000493-2, datë 3.5.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin Roland Këndezi, me NIPT L91604023G, përfaqësues i autorizuar i subjektit Z. Roland Këndezi, ID I11001048Q, prej datës 3.5.2019, ora 08:00 deri më datën 3.5.2019, ora 16:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datë 3.5.2019 dhe e njoftoi më datën 3.5.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, neni 29, pika “1/a/iii”,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit “Nuk ka”, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 300 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Pezullim plotësisht të aktivitetit deri në pajisje me Leje Mjedisit Tip C

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

17.5.2019 - Subjekti duhet të dorëzojë pranë zyrave të ISHMPUT-Tiranë, Lejen e Mjedisit Tip C që e pretendon se e disponon.

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Besmir Stafa ID: 0301020005

Arjan Cela ID: 0301010016

*Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti “**Roland Këndezi**” ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.*